



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Nr. 5715 Prot

Tiranë, më 28.04.2022

URDHËR

Nr. 150, Datë 28.04.2022

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR MINISTRINË PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME 2022-2025”

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të Vendimit Nr. 516, datë 01.07.2020, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën 2015-2020 dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve”.

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme 2022-2025, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjithë drejtoritë e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
3. Ky urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

